

Përshëndetje,

Komisioni i Organizimit të Shortit në përgjigje të kërkesës së z. Dorian Matlija, protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. D-24544, datë 29.12.2025, deleguar pranë strukturës sonë me anë të shkresës nr. Prot. D-24544/1, datë 12.01.2026, mbi numrin e banorëve të cilët kanë përfituar banesë në zonën e Kombinatit për shkak të mbetjes i pastrehë nga dëmtimi i tërmetit të datës 29.11.2019, dhe kopje të listës së banorëve të cilët kanë përfituar banesë në zonën e Kombinatit, ju bën me dije si më poshtë:

- Nëpërmjet procesit të Shortit Publik, deri më tani janë shpërndarë 268 njësi banimi tek subjektet e rindërtimit (subjektet përfitues nga programi i zhvillimit të objekteve të reja), në Zonën e re për Zhvillim në Kombinat;
- Njoftimet mbi pjesëmarrjen e subjekteve përfituese në short publik, afishohen në standat e Njësisë Administrative perkatëse dhe faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë.

Linku i aksesimit: <https://tirana.al/kategori/njoftime>

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Komisioni i Organizimit të Shortit